KONTRATË

PËR ZGJATJEN DHE PËRMIRËSIMET E KONTRATËS SË KONCESIONIT

"PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE"

DATË 21 KORRIK, 2008, E NDRYSHUAR

NDËRMJET

MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe

GRUPIMIT

MORPHO

E

FONDI SHQIPTARO - AMERIKAN I NDËRMARRJEVE

NËNSHKRUAR NË TIRANË, MË ___ 2013

PËRMBAJTJA

1. Ndryshim i Kontratës së Koncesionit

2. Shtojcat

- Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 dhe Shtojca 3)
- Shtojca 11 (Aspektet Financiare)
- Shtojca 12 (Garancia e Kontratës)
- Shtojca 22 (Lista e Aseteve të Koncesionit)

KJO KONTRATË (në vijim referuar si **"Kontrata"**) lidhet në Tiranë, Shqipëri, më 19/03/2013.

NDËRMJET:

Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si "**Autoriteti**"), e përfaqësuar rregullisht nga Ministri i Brendshëm **Z.Flamur Noka,**

dhe

grupimi vijues i shoqërive:

Morpho(njohur më parë nën emrin Sagem Sécurité, siç vërtetohet nga Certifikata e Regjistrit Tregtar Francez N° 2001 B 19665), një shoqëri aksionare («société anonyme»), me një kapital prej 159 876 075 Euro, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar dhe të Shoqërive të Nanterre, me numrin 440305282, me seli në adresën 11, boulevard Galliéni– 92130 Issy-les-Moulineaux, Francë, përfaqësuar nga Z. Jean-Paul Jainsky, i autorizuar rregullisht për qëllimet e kësaj Kontrate, në cilësinë e tij të Kryetarit dhe Shef Ekzekutiv,

dhe

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, një shoqëri jo fitimprurëse e themeluar sipas ligjeve të Shtetit Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me seli në adresën 14 East 60th Street, Suite 407, New York, NY 10022 USA, me një zyrë përfaqësimi në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", Kompleksi "Green Park", Kulla 2, Kati 11, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z.Aleksandër Sarapuli**,dhe **Z.Martin Mata**, të autorizuar rregullisht për qëllimet e kësaj Kontrate.

Grupimi i mësipërm do të referohet në vijim si "**Koncesionari**";

Në përputhje me sa vijon:

- Ligj nr. 9972, datë 28.07.2008 *"Për ratifikimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike" ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të Sagem Sécurité e Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve";*

- Ligj nr. 10322, datë 23.09.2010 *"Për ratifikimin e shtesës së kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike" ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të Sagem Sécurité e Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve";*

- Ligj nr. 8952, datë 10.10.2002 *"Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë"*, i

ndryshuar;

- Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008, *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*;

- Ligj nr. 10 273, datë 29.04.2010 *"Për dokumentin elektronik"*;

- Ligj nr. 9880, date 25.02.2008, *"Për nënshkrimin elektronik"*, i ndryshuar me Aktin Normativ nr. 8, datë 30.09.2009;

- Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar;

- Ligj nr. 9663, datë 18.12.2006 *"Për Koncesionet"*, i ndryshuar;

- Ligj nr. 10 325, datë 23.09.2010 *"Për bazat e të dhënave shtetërore"*;

- Ligj nr. 9742, datë 28.05.2007, *"Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë"*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 26.07.2006, *"Për miratimin e modelit të pasaportave dhe përmirësimin e sistemit të lëshimit të tyre"*, i ndryshuar;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 13.7.2007 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.541, datë 26.7.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të pasaportave dhe përmirësimin e sistemit të lëshimit të tyre"*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253 datë 27.04.2007 *"Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë" i ndryshuar*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 715 datë 06.11.2007 *"Për disa ndryshime në vendimin nr.253, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë"*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 13.04.2007, *"Për miratimin e projektit "Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe të pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë" dhe ..."*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525 datë 08.08.2007;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 10.04.2003, *"Për miratimin e dokumentit të strategjisë kombëtare të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit"*;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e dokumentit të politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë;*

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 13.05.2009 *"Për miratimin e rregullores për nënshkrimin elektronik";*

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 13.05.2009 *"Për miratimin e tarifave për shërbimet, që ofrohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik";*

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 27.04.2007 *"Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit";*

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 01.09.2010 *Për projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit".*

- Udhëzim nr. 001 i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik për përdorimin e nënshkrimit elektronik, shtator 2011;

- Udhëzim nr. 002, Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, për përdorimin e nënshkrimit elektronik, nëntor 2012;

- Udhëzim nr. 003, i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, për përdorimin e nënshkrimit elektronik, shtator 2012;

- Udhëzim nr. 004, datë 05.05.2012, i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, *"Për Afatet e Përgjithshme";*

- Udhëzim nr. 005, datë 17.02.2010 i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik *"Për dokumentacionin e regjistrimit të ofruesit të shërbimit të certifikimit";*

- Udhëzim nr. 007, datë 05.05.2012 i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, *"Për deklaratën e përfaqësuesit ligjor";*

Duke pasur parasysh dhe dispozitat e Direktivës 1999/93/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, date 13 dhjetor 1999, mbi një kuadër ligjor të Komunitetit për nënshkrimet elektronike;

si edhe:

- Rregullore Nr. 2252/2004 të Këshillit të Evropës(EC) datë13 dhjetor 2004 "Mbi standardet dhe karakteristikat e sigurisë dhe biometrisë në pasaporta dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga Vendet Anëtare";

- Rregullore nr. 15/152/04, të Këshillit të Evropës, date 15 dhjetor 2004 "Mbi standardet dhe karakteristikat e sigurisë dhe biometrisë në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga Vendet Anëtare"; dhe

- Draft Rregullorja e Përfaqësuesve të Qeverive të Vendeve Anëtare "Mbi standardet e përbashkëta minimale të sigurisë për 'kartat e identitetit kombëtare' të Vendeve Anëtare, nr. 15356/06 JAI 598.

Dhe

MEQËNËSE:

A. Autoriteti ka lidhur me grupimin e shoqërive Morpho (më parë e njohur si SagemSécurité) e Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, më 21 korrik 2008, kontratën e koncesionit *"Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike"*(në vijim "**Koncesioni**", ose "**Kontrata e Koncesionit**") për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, ratifikuar e ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, te ndryshuar më datë 13 korrik 2010, miratuar me ligjin nr. 10322, datë 23.09.2010.

B. Në përputhje me Kontratë e Koncesionit, Koncesionari ka themeluar shoqërinë koncesionare **ALEAT Shpk** (në vijim e referuar si "**ALEAT**", ose "**Shoqëria Koncesionare**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e cila vepron sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 18 gusht 2008, me numër unik identifikimi NUIS K82018015V, me seli pranë Rr. Xhanfize Keko, Tiranë, Shqipëri.

C. Autoriteti pranon dhe bie dakord se në datën e kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare ka përmbushur në kohë dhe siç duhet detyrimet dhe angazhimet në përgjegjësi të saj, siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit, të ndryshuar, si dhe ka zbatuar rregullisht investimet e nevojshme në pajisjet hardware dhe software që përbëjnë Sistemin, siç përcaktohet në Kontratën e Koncesionit (një listë e aseteve të tanishme të Koncesionit i bashkëlidhet Kontratë së Koncesionit si Shtojcë e re, nr. 22, siç specifikohet më poshtë).

D. Autoriteti pranon më tej se infrastruktura e shërbimit, nivelet e shërbimit dhe standardet e ngritura nga Shoqëria Koncesionare kanë plotësuar siç duhet objektivin për t'i shërbyer interesit publik, dhe konsiderohet se është në interes të dyanshëm të palëve zhvillimi i

mëtejshëm i kësaj infrastrukture shërbimi, nëpërmjet përditësimit dhe përmirësimit të niveleve të shërbimit dhe të teknologjisë e duke përdorur në mënyrë efikase infrastrukturën ekzistuese të Shoqërisë Koncesionare, në mënyrë që të ofrohen shërbime shtesë identifikimi të sigurte për shtetasit shqiptarë dhe rezidentët, në përputhje me Nenin 15 të Kontratës së Koncesionit.

E. Duke pasur parasysh se sasia minimale prej së paku 3.6 milion Karta Identiteti të shitura siç parashikohet tek Neni 3.3.2, ka gjasa te mos realizohet, kjo jo për Pazotësi të Koncesionarit.

F. Qeveria shqiptare ka shprehur vendosmërinë e saj për shfrytëzimin e potencialit të plotë të Dokumenteve te Identifikimit të prodhuara në kuadrin e Kontratës së Koncesionit, me qëllim përdorimin e Dokumenteve të Identifikimit si bazë për zhvillimin e shërbimeve digitale online që do tu ofrohen ofruesve publikë apo privatë të shërbimeve dhe shtetasve të Republikës së Shqipërisë, në kuadrin e e-Albania, dhe të e-Shërbimeve për mbështetjen e biznesit privat.

G. Është një praktikë e zakonshme në gjithë vendet e Bashkimit Evropian, e imponuar edhe nga Rregulloret e posaçme të BE-së të lartpërmendura, sipas të cilës Dokumentet e Identifikimit janë objekt i një përditësimi dhe përmirësimi konstantdhe shtrirje progresive të funksioneve, në drejtim të rritjes së sigurisë së dokumenteve dhe lehtësimit të ndërveprimit ndërmjet ofruesve publikë e private të shërbimeve në platformat elektronike.

H. Bazuar në faktet dhe dokumentet e mësipërme, Palët bien dakord të zgjasin Kontratën e Koncesionit me qëllim të posaçëm përmirësimin dhe përditësimtëShërbimeve ekzistuese, shfrytëzimin në nivel maksimal të aftësive dhe potencialite Sistemit, si dhe ofrimin e disa shërbimeve plotësuese dhe produkteve për shtetasit shqiptarë, në përputhje me qëllimin dhe parashikimet e Kontratës së Koncesionit, siç parashikohet në këtë shtesë të Kontratës së Koncesionit;

Sa më lart, Palët bien dakord të ndryshojnë Kontratën e Koncesionit si vijon:

Neni 1

Tek Nenin 3.2 i Kontratës së Koncesionit shtohet paragrafi si vijon:

"Palët bien dakord që Kontrata e Koncesionit të zgjatet deri më 31 korrik 2023."

Neni 2

2.1 Në Shtojcën 1 (Përkufizimet) të Kontratës së Koncesionit shtohen dhe/ose ndryshohen përkufizimet e mëposhtme, dhe zëvendësohen si vijon:

- ***"Shërbimi Bazë i Identifikimit"*** *–do të ketë kuptimin: procesi i njëpasnjëshëm për përcaktimin e vlefshmërisë dhe sigurimin e identitetit të pretenduar të një personi, bazuar në hyrje/fjalëkalim/fakte të njohura (autentifikim), dhe në verifikimin e identitetit të personit (identifikim) nga Platforma ESB.*

- ***"ShërbimeDixhitale për Verifikimin e Identitetit"*** *–do të ketë kuptimin: shërbimet e autentifikimit, identifikimit dhe përzgjedhjes,dhe nënshkrimit dixhital të kualifikuar, siç përshkruhet tek Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit), të kësaj Marrëveshje.*

- ***"Tarifa e Shërbimeve Dixhitale per Verifikimin e Identitetit"*** *–do të ketë kuptimin: shuma e pagueshme nga institucionet publike dhe nga sektori privat, si dhe nga gjithë përdoruesit e tjerë, për përdorimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit nëpërmjet Platformës e-Trust, siç përcaktohet në Shtojcën 11 (Aspektet Financiare) të kësaj Marrëveshje.*

- ***Shërbime për Identifikimin dhe Përzgjedhjen"*** *– do të ketë kuptimin: veprimtaria nëpërmjet të cilës verifikohet se një person kualifikohet për të hyrë dhe përdorur ShërbimetDixhitale për Verifikimin e Identitetitnë përputhje me kërkesat e identifikimit dhe përzgjedhjes, bazuar në të dhënat dhe tiparet e Kartës së Identitetit, siç përshkruhet në Shtojcën 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)),të kësaj Marrëveshje.*

- ***Platforma e Ndërveprimit tëShërbimeve(ESB) /Platforma e Ndërveprimit"*** *– do të ketë kuptimin: e-Albania dhe Platforma e Ndërveprimit të Republikës së Shqipërisë e drejtuar nga AKSHI me qëllim ndërlidhjen e sistemeve informative të institucioneve të ndryshme publike shqiptare dhe bazave të të dhënave kombëtare, në veçanti shërbimin e-Pagesa dhe Shërbimin Bazë të Autentifikimit.*

- ***"Shërbimi e-Pagesa"*** *– do të ketë kuptimin: shërbimi i cili mundëson pagesat online të Qytetarëve për e-Shërbimet e ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve.*

- ***"Platforma e-Trust"*** *– do të ketë kuptimin: nënsistemi që ofron ShërbimeDixhitale për Verifikimin e Identitetitsiç përshkruhet tek Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)), të kësaj Marrëveshje.*

- ***"Përdoruesit e Platformëse-Trust"*** *–do të ketë kuptimin: gjithë individët dhe/ ose personat fizikë të cilët do të hyjnë dhe përdorin shërbimet e Platformës e-Trust, siç përshkruhet kjo e fundit tek Shtojca 4 Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)), të kësaj Marrëveshje.*

- ***"Shërbimi i Identifikimit"*** *– do të ketë kuptimin: procesi i njëpasnjëshëm për përcaktimin e vlefshmërisë dhe sigurisë së identitetit të pretenduar të një përdoruesi të e-Trustit, bazuar në Kartën e Identitetit (autentifikim) dhe verifikimi i identitetit të përdoruesit të e-Trustit (identifikim) siçpërshkruhet tek Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)), të kësaj Marrëveshje.*

- ***"AKSHI"*** *– do të ketë kuptimin:Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të Republikës së Shqipërisë.*

- ***"Investim i Ri"*** *-do të ketë kuptimin: investimi i ri në hardware dhe software i Koncesionarit i programuar gjatë 10 viteve të periudhës së zgjatur të Koncesionit dhe i paraqitur në hollësi tek Seksioni 6 i Shtojcës 11.*

- ***"Dokumente të Tjera Identifikimi"*** *– do të ketë kuptimin: çdo dokument tjetëridentifikimi, duke përfshirë por pa u kufizuar tek: lejet e qëndrimit për të huajt, lejet e drejtimit të automjeteve, dokumentet e identifikimit të nëpunësve civilë, e lloje të tjera të mundshme dokumentesh, që mund të projektohet, prodhohen dhe shpërndahen nga Koncesionari me kërkesën e posaçme dhe në përputhje me specifikimet teknike të dhëna nga Autoriteti, pas marrëveshjes dypalëshe të posaçme ndërmjet Palëve të Koncesionit.*

- ***"Shërbimi i Nënshkrimit Dixhital të Kualifikuar"*** *–do të ketë kuptimin: veprimtaria nëpërmjet të cilës sigurohet nënshkrimi i duhur i dokumenteve elektronikë nga Përdoruesit e Platformës e-Trust, siç përshkruhet tek Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)), të kësaj Marrëveshje.*

- ***"Shërbimet"****–do të ketë kuptimin: zhvillimi i Koncesionit dhe çdo, e të gjitha shërbimet që do të ofrohen nga Koncesionari sipas kësaj Marrëveshje".*

- ***"Nënsistemi për Ofrimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit"*** *– do të ketë kuptimin: nënsistemi përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të autentifikimit, identifikimit dhe përzgjedhjes, dhe nënshkrimit dixhital të kualifikuar, siç përshkruhet tek Shtojca 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)), të kësaj Marrëveshje.*

- *"Ofruesit e Shërbimeve"- do të ketë kuptimin institucionet publike dhe /ose private që ofrojnë shërbime digjitale për përdoruesit e e-Trust, bazuar në ShërbimetDixhitale për Verifikimin e Identitetit. Në këtë përkufizim:*
    - ***"Ofrues Publikë të Shërbimeve"** –do të ketë kuptimin të gjitha entet qendrore dhe vendore qeveritare shqiptare, organet e administratës publike, si edhe drejtoritë përkatëse, agjencitë, dhe sektorët, duke përfshirë por pa u kufizuar tek ministritë shqiptare, gjykatat, zyrat e prokurorisë, Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, organet tatimore, institucionet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, Policia e Shtetit, etj, të cilat ofrojnë shërbime online për palë të treta.*
    - ***"Ofrues Privatë të Shërbimeve" –** do të ketë kuptimin të gjitha shoqëritë tregtare dhe institucione jo-fitimprurëse, që kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, si edhe organizata të tjera dhe/ose ente të cilat veprojnë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar tek institucionet financiare private, bankat, shoqëritë e sigurimit, zyrat noteriale, operatorët e telefonisë, zyrat postare, etj, të cilët ofrojnë shërbime online për palë të treta.*

2.2 Tek Shtojca 1, (Përkufizime) e Kontratës së Koncesionit tek përkufizimi "Shërbime Shtesë" shtohet një paragraf:***"5. Furnizimi i Dokumenteve të Tjera të Identifikimit".***

2.3 Tek Shtojca 1, (Përkufizime) e Kontratës së Koncesionit tek përkufizimi "Sistem" shtohet nënsistemi***"(vi) Nënsistemi për ofrimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit".***

Neni 3

3.1 Shtojca 4 (Përmirësimet e Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit), Shtojca 11 (Aspektet Financiare), dhe Shtojca 12 (Garancia e Kontratës), bashkëlidhur kësaj Kontrate, zëvendësojnë shtojcat 4, 11, 12, dhe 21 të Kontratës së Koncesionit, të ndryshuar. Shtojca 22 (Lista e Aseteve të Koncesionit) i bashkëlidhet si shtojcë e re Kontratës së Koncesionit.

3.2 Neni 1.5 i Kontratës së Koncesionit ndryshohet si vijon:

"1.5 ***Për shmangien e çdo dyshimi, nëse ka ndonjë kontradiktë ndërmjet Neneve dhe Shtojcave apo dokumenteve të tjera të referuara në këtë Marrëveshje, kontradikta do të zgjidhet duke i dhënë gjithmonë përparësi Neneve, Shtojcës 1 (Përkufizimet), Shtojcës 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 dhe Shtojca 3), dhe Shtojcës 11 (Aspektet Financiare)."***

Neni 4

Neni 3.1 "Dhënia e Koncesionit" i Kontratës së Koncesionit ndryshohet si vijon:

Tek paragrafi 3.1.1 të Kontratës së Koncesionit, në fund të paragrafit shtohet si vijon:

"dhe ofrimi i Shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë."

Tek paragrafi3.1.2,shtohet një paragraf (vi)si vijon:

(vi) Nënsistemi për ofrimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit:

- *Shërbimi i Identifikimit, bazuar në të dhënat dhe karakteristikat e Dokumenteve te Identifikimit.*
- *Shërbimi përIdentifikimin dhe Përzgjedhjen, bazuar në të dhënat dhe karakteristikat e Dokumenteve te Identifikimit.*
- *Shërbimi i Nënshkrimit Dixhital të Kualifikuar, bazuar në të dhënat dhe karakteristikat e Dokumenteve të Identifikimit.*

Tek paragrafi 3.1.3 shtohet një paragraf (vii) si vijon:

(vii) projektimi, krijimi, zhvillimi, zbatimi, përmirësimi, dhe shtrirja e funksioneve dhe veprimtarisë së Sistemit, për ofrimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetitpër sektorin publik dhe privat, sipas Shtojcës 4 (Përmirësime të Miratuara tek Shtojca 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Shtojca 3 (Zgjidhja e Koncesionarit)).

Tek paragrafi 3.1.3 shtohet një paragraf (viii)si vijon:

"(viii) projektimi, krijimi, zhvillimi, zbatimi,dhe funksionimi i Sistemit për ofrimin e mundshëm të Dokumenteve të Tjera të Identifikimit bazuar, në specifikimet teknike dhe financiare që do të miratohen nga Palët rast pas rasti."

Neni5

Tek Kontrata e Koncesionit shtohet neni 17.5.4, si vijon:

"17.5.4. Tarifa e Shërbimit Dixhital për Verifikimin e Identitetittë ofruar sipas kësaj Marrëveshje, do të përcaktohet me marrëveshje dypalëshe (memorandum) të Palëve, në përputhje me mekanizmin e parashikuar tek Shtojca 11 (Aspektet Financiare)."

Neni 6

Neni 28.2i Kontratës së Koncesionit ndryshohet si vijon:

"28.2 Nëse kërkohet nga Autoriteti, Morpho do të sigurojë mirëmbajtjen vjetore siç përcaktohet në Nenin 28.1 deri në 4 vjet pas Periudhës së Garancisë, për një çmim fiks prej 182.049.96.5 Lekë në vit (duke përjashtuar TVSH)."

Neni7

7.1 Tek Kontrata e Koncesionit shtohet një nen 39.7, si vijon:

"39.7Autoriteti do të bëjë gjithë përpjekjet e do të marrë gjithë masat për promovimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetitnë Shqipëri. Për këtë qëllim, Autoriteti do të ndërmarrë të gjithë masat dhe veprimet e nevojshme e të përshtatshme në mënyrë që:

(i) të zbatojë e promovojë përdorimin e Kartave të Identitetit, dhe zhvillimin e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit, nëpërmjet Platformës e-Trust të Koncesionarit;

(ii) të inkurajojë e mbështesë Ofruesit e Shërbimeve për të zhvilluar dhe përdorur Shërbimet Dixhitale për Verifikimin e Identitetit;

(iii) të sigurojë që të gjitha pagesat e shërbimeve publike dhe tarifat për shërbimet që përdorin Platformën e-Trust, të përfshijnë edhe Tarifën e Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit.

Në rast se pas një periudhe 2 vjeçare nga Data Efektive, pavarësisht përpjekjeve të Autoritetit dhe ngritjes së Platformës e-Trust nga Koncesionari, Shërbimet Dixhitale për Verifikimin e Identitetitnuk përdoren efektivisht dhe mjaftueshëm nga publiku, dhe/ose në rast se veprimtaria tregtare dhe Shërbimet Dixhitale për Verifikimin e Identitetittë Koncesionarit nuk krijojnë të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar zhvillimin e saj të mëtejshëm, atëherë, Koncesionari pa cënuar të drejtat dhe zgjidhjet e tjera të tij të parashikuara në këtë Kontratë, (i) do të ketë të drejtë të ndalojë gjithë investimet e mëtejshme lidhur me Platformën e-Trust, ose (ii) me marrëveshje të të dyja Palëve do të vendoset mbi zhvillimin e mëtejshëm të biznesit të Shërbimeve Dixhitale për Verifikimin e Identitetit."

7.2 Tek Neni 42.1 i Kontratës së Koncesionit shtohet si vijon:

"Palët presin që gjatë periudhës së zgjatur të Koncesionit, nga 25 korrik 2013 deri ne 31 korrik 2023, volumi i Dokumenteve të Identifikimit do të arrijë një minimum prej 3.4 milionë Karta Identiteti dhe 3.4 milionë Pasaporta. Në rast të ndonjë ngjarje jo në ngarkim të Shoqërisë Koncesionare, e cila ndikon negativisht tek volumi i lartpërmendur i Dokumenteve të Identifikimit, duke përfshirë ndryshimet në Ligjin e Zbatueshëm, apo parashikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe vendeve të tjera të huaja apo organizatave ndërkombëtare, ose ndonjë veprimi tjetër që ndikon në përdorimin e Dokumenteve të Identifikimit, Palët do të takohen pa vonesë për të rënë dakord mbi një kompensim të përshtatshëm financiar për Shoqërinë Koncesionare.

7.3 Neni 54.4 paragrafi (v) (Garancia e Kontratës) të Kontratës së Koncesionit ndryshohet si vijon:

(iv) Vlefshmëria e shumës së mbetur prej 2.500.000 Euro të Garancisë së Kontratës do të zgjatet për të garantuar detyrimet e Koncesionarit lidhur me kryerjen e Investimit të Ri. Zgjatja e vlefshmërisë të Garancisë së Kontratës do të konfirmohet nga banka që e lëshon atë, në formën e përcaktuar tek Shtojca 12 (Garancia e Kontratës). Garancia e Kontratës do të zbritet më tej në përputhje me zbatimin nga Koncesionari të Investimit të Ri, siç përcaktohet tek Shtojca 12 (Garancia e Kontratës)."

Neni8 – Hyrja në fuqi dhe Data Efektive

8.1 Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi pa hyrjes në fuqi të ligjit të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë i cili miraton këtë Kontratë.

8.2 Në rast se Data Efektive nuk ndodh brenda një periudhe prej 120 (një qind e njëzetë) Ditë Pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët, cilado prej Palëve do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë duke i dërguar Palës tjetër një Njoftim për Përfundim prej të paktën 5 (pesë) Ditë Pune përpara. Pas marrjes së një Njoftimi të tillë për Përfundim, Palët e kësaj Kontrate nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Kontrate, përveç të drejtave dhe detyrimeve të tilla që sipas termave të tyre të shprehura i mbijetojnë zgjidhjes së kësaj Kontrate.

8.3 Palët bien dakord që në rast të ndonjë përplasje parashikimesh të Kontratës së Koncesionit, parashikimet dhe ndryshimet e parashikuara në këtë Kontratë do të mbizotërojnë, nëse do të ketë ndonjë përplasje ndërmjet këtyre dokumenteve.

8.4 Për çdo çështje tjetër që nuk parashikohet në këtë Kontratë do të zbatohen parashikimet përkatëse të Kontratës së Koncesionit.

Në dëshmi të sa më lart, Palët dhe përfaqësuesit e tyre përkatës e nënshkruajnë këtë Kontratë rregullisht .

Për Ministrinë e Brendshme
të Republikës së Shqipërisë:

Për Koncesionarin:

Morpho: